



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 86

Tiranë – E mërkurë, 21 maj 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 140, datë 12.5.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 11695
Dekret i Presidentit nr. 141, datë 12.5.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 11695
Dekret i Presidentit nr. 142, datë 12.5.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 11695
Dekret i Presidentit nr. 143, datë 13.5.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11696
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 271, datë 9.5.2025	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 11696
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 438, datë 7.5.2025	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 554, datë 22.7.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pestës së ruminantëve të vegjël të shfaqur në shtetin e Greqisë”; urdhrit nr. 237, datë 7.3.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pestës së ruminantëve të vegjël të shfaqur në shtetin e Rumanisë”; urdhrit nr. 1025, datë 26.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pestës së ruminantëve të vegjël të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”; urdhrit nr. 87, datë 30.1.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pestës së ruminantëve të vegjël të shfaqur në shtetin e Hungarisë”.... 11731
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 439, datë 7.5.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 11731

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 440, datë 7.5.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	11733
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 441, datë 7.5.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	11734
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 442, datë 7.5.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë..	11735
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 443, datë 7.5.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Greqisë.....	11736
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 455, datë 9.5.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar	11737
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 456, datë 9.5.2025	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 132, datë 13.2.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Çekisë”.....	11739
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 457, datë 9.5.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Greqisë.....	11740
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 6886, datë 14.5.2025	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare	11741
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 121, datë 19.5.2025	Për delegim kompetencash.....	11741
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 10.4.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 819, datë 21.3.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.....	11741
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 25, datë 7.5.2025	Për vendosjen e kufijve të sipërm për treguesit “Raporti i kredisë ndaj vlerës” dhe “Raporti i shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave” për kreditë që japin bankat për pasuri të paluajtshme rezidenciale.....	11747
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 421/9, datë 14.5.2025	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Qendra Multifunkionale në luginën e Vjosës, Stacioni i Informimit Vlorë”.....	11748

**DEKRET****Nr. 140, datë 12.5.2025****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Mateo Dritan Çullhaj
2. Aleksia Dritan Çullhaj
3. Anita Agim Myftaraj
4. Erind Ilmi Miraka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 141, datë 12.5.2025****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ina Ilia Dhrami
2. Rigerta Kastriot Demiri

3. Orilda Llazar Laze
4. Arlinda Pellumb Parllaku
5. Artemida Kastriot Bizhga

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 142, datë 12.5.2025****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Idris Xhevat Idrizi
2. Ormir Orhan Gjurgje
3. Lora Vilson Muço

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



DEKRET
Nr. 143, datë 13.5.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Leon Faruk Sylejmani
2. Hassan Altan Haradini

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 271, datë 9.5.2025

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.
1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË
VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË
BASHKIMIT EVROPIAN PËR
VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE,
TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të

ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 9, pas fjalëve “... (CFSP) 2024/2075 ...” shtohen “... (CFSP) 2025/690, “... (CFSP) 2025/774 ...”;

b) Në pikën 25, pas fjalëve “... (CFSP) 2025/394 ...” shtohen “... (CFSP) 2025/700 ...”.

2. Në aneksin 9, bashkëlidhur vendimit, shtohen vendimet (CFSP) 2025/690, (CFSP) 2025/774, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Në aneksin 25, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2025/700, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



2025/690

7.4.2025

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2025/690

më 4 prill 2025

ndryshimin e Vendimit 2011/235/CFSP në lidhje me masat kufizuese të drejtuara kundër
personave dhe subjekteve të caktuara në funksion të situatës në Iran

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të

Sigurisë, duke pasur parasysh:

- (1) Më 12 prill 2011, Këshilli miratoi Vendimin 2011/235/CFSP⁽¹⁾.
- (2) Në bazë të një rishikimi të Vendimit 2011/235/CFSP, Këshilli konsideron se masat kufizuese të përcaktuara në të duhet të rinovohen deri më 13 prill 2026.
- (3) Këshilli ka arritur në përfundimin se shënimet në lidhje me dy persona të caktuar në Aneksin e Vendimit 2011/235/CFSP duhet të hiqen dhe se shënimet në lidhje me 20 persona duhet të përditësohen.
- (4) Prandaj, Vendimi 2011/235/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2011/235/CFSP ndryshohet si më poshtë:

- (1) në nenin 6, paragrafi 2, data "13 prill 2025" zëvendësohet me atë "13 prill 2026";
- (2) shtojca ndryshohet në përputhje me aneksin e këtij vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian. Bërë në Bruksel,

më 4 prill 2025.

*Për Këshillin**Presidenti*

A. SZŁAPKA

⁽¹⁾ Vendimi i Këshillit 2011/235/CFSP i datës 12 prill 2011 lidhur me masat kufizuese të drejtuara kundër personave të caktuar dhe subjekteve në funksion të situatës në Iran (OJ L 100, 14.4.2011, f. 51, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2011/235/oj>).



SHQI

OJ L, 7.4.2025

ANEKSI

Aneksi i Vendimit 2011/235/CFSP ("Lista e personave dhe subjekteve të përmendura në nenet 1 dhe 2") është ndryshuar si më poshtë:
(1) në listën me titull "Personat", shënimet 68 (për RAMIN Mohammad-Ali) dhe 169 (për NULRUSHAN Abbas Mortaza) janë fshirë;
(2) në listën e titulluar "Personat", shënimet për 20 personat e mëposhtëm zëvendësohen me:

Personat			
	Emri	Informacion identifikues	Arsyet
'23.	PIR-ABASSI Abbas	Gjinia: mashkull Funksioni: Gjyqtar në Komplexin Gjyqësor Shahid Muftah; ish magjistrat i një dhome penale; ish-gjyqtar, Gjykata Revolucionare e Teheranit, dega 26	Gjyqtar në Komplexin Gjyqësor Shahid Muftah. Ish magjistrat i një dhome penale, ish-gjyqtar. Gjykata Revolucionare e Teheranit, dega 26. Ai ishte përgjegjës për çështjet paszgjedhore. Ai dha dënime të gjata me burgim gjatë gjyqeve të padrejtë kundër aktivistëve të të drejtave të njeriut dhe dha disa dënime me vdekje për protestuesit.
29.	BOZORGNIA Mostafa	Gjinia: mashkull Funksioni: Shef reparti 350 i Burgut Evin	Shef i pavijonit 350 të Burgut të Evin, i njohur si vendi i burgimit të të burgosurve politikë të regjimit dhe për kushtet veçanërisht të këqija të paraburgimit. Ai lëshoi në një sërë rastesh dhunë disproporcionale ndaj të burgosurve.
33.	ABBASZADEH-MESHKINI Mahmud	Gjinia: mashkull	Anëtar i Parlamentit nga shkurti 2020 deri në 2024 dhe Kryetar i Komisionit të Parlamentit për Sigurinë Kombëtare dhe Punët e Jashtme, i cili vazhdon të mbështesë regjimin iranian, përfshirë këtu duke justifikuar abuzimet e kryera nga regjimi kundër lëvizjes "Gratë, Jeta, Liria". Këshilltar i Këshillit të Lartë të Iranit për të Drejtat e Njeriut deri në vitin 2019. Ish-sekretar i Këshillit të Lartë për të Drejtat e Njeriut. Ish-guvernator i provincës Ilam. Ish-drejtor politik i Ministrisë së Brendshme. Si Kryetar i Komisionit të Nimit 10 të Ligjit për Veprimtarinë e Partive dhe Grupeve Politike, ai ishte përgjegjës për autorizimin e demonstratave dhe ngjarjeve të tjera publike dhe regjistrimin e partive politike. Në vitin 2010, ai pezulloi aktivitetet e dy partive politike reformiste të lidhura me Mir-Hossein Mousavi - Fronti i Pjesëmarrjes së Iranit Islamik dhe Organizata Muxhahedine e Revolucionit Islamik. Nga viti 2009 e tutje, ai vazhdimisht dhe në vazhdimësi ka ndaluar të gjitha tubimet joqeveritare, dhe për këtë arsye ka mohuar të drejtën kushtetuese për të protestuar dhe ka shkakuar shumë arrestime të demonstruesve paqësorë në kundërshtim me të drejtën e lirisë së tubimit. Në vitin 2009, ai gjithashtu i mohoi opozitës një leje për një ceremoni për të mbajtur zi për njerëzit e vrarë në protestat për zgjedhjet presidenciale.



OJ L, 7.4.2025

SHQIP

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
40.	HABIBI Mohammad Reza	Gjinia: mashkull Funksioni: Kryetar i Gënjatës së Isfahanit; ish Prokurori i Përgjithshëm i Isfahanit; ish zëvendësprokuror i Isfahanit; ish shef i zyrës së Ministrisë së Drejtësisë në Yazd	Shefi i Drejtësisë së Isfahanit, ish-Prokurori i Përgjithshëm i Isfahanit, ish-Zëvendësprokurori i Isfahanit dhe ish Shefi i zyrës së Ministrisë së Drejtësisë në Yazd. Në rolet e tij të ndryshme në gjyqësorin e Isfahanit dhe Yazdit, përfshirë edhe në rolin e tij aktual si Kryegjykatës i Isfahanit, ai ka marrë pjesë drejtpërdrejt dhe është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të qytetarëve, në veçanti të së drejtës për lirinë e fjalës, të drejtën për protestë, të drejtën e jetës dhe shkeljen e ndalimit të torturës. Mohammad Reza Habibi gjithashtu luajti një rol të drejtpërdrejtë në shpënjien dhe shkeljen e rëndë të së drejtës për të protestuar gjatë protestave mbarrëkombëtare në janar 2017 dhe nëntor 2019. Prandaj, në rolin e tij si Kryegjykatës i Isfahanit, ai është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	10.10.2011
46.	KAMALIAN Behrouz (i njohur gjithashtu si Hackers Brain /Truri i Hakerëve/, Behrooz_Ice)	Vendi i lindjes: Teheran (Iran) Data e lindjes: 1983 Gjinia: mashkull Funksioni: Shef i grupit kibernetik "Ashiyaneh".	Kreu i grupit kibernetik "Ashiyaneh" i lidhur me regjimin iranian. Siguria dixhitale "Ashiyaneh", e themeluar nga Behrouz Kamalian, është përgjegjëse për sulme intensive kibernetike si ndaj kundërshtarëve vendas, ashtu edhe ndaj reformistëve dhe institucioneve të huaja. Puna e organizatës "Ashiyaneh" e Kamalian ka ndihmuar në goditjen e regjimit kundër opozitës, e cila ka përfshirë shkelje të shumta të rënda të të drejtave të njeriut.	10.10.2011
48.	MAHSOULI Sadeq (i njohur gjithashtu si MAHSULI Sadeq)	Vendi i lindjes: Oroumieh (Iran) Data e lindjes: 1959/1960 Gjinia: mashkull Funksioni: Sekretar i Përgjithshëm (dhe ish Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm) i Frontit Paydari (Fronti i Stabilitetit Islamik)	Sekretar i Përgjithshëm i Frontit Paydari (Fronti i Stabilitetit Islamik) që nga viti 2021 dhe Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm i Frontit Paydari përpara vitit 2021. Fronti Paydari ka qenë prej kohësh aktiv në praktikën e kapjes së shtetit, duke infitruar në institucione dhe duke indoktrnuar Korpusin e Gardës Revolucionare Islamike (IRGC). Në vazhden e lëvizjes "Gratë, Jeta, Liria", e nisur në shtator 2022, Fronti Paydari, nën udhëheqjen e Mahsouli, luajti një rol kritik në shpërrjen e ligjeve drakomiane të hixhabit dhe dëbrësise. Mahsouli është një ish-këshilltar i ish-presidentit Mahmoud Ahmadinejad. Ai është gjithashtu ish-anëtar i Këshillit të Përshatshmërisë dhe ish Zëvendës Shefi i Frontit të Këmbënguljes. Ai ishte Ministër i Mirëqenies dhe Sigurimeve Shoqërore midis 2009 dhe 2011 dhe Ministër i Brendshëm deri në gusht 2009. Si Ministër i Brendshëm, Mahsouli kishte autoritet mbi të gjitha forcat e policisë, agjentët e sigurimit të ministrisë së brendshme dhe agjentët e veshjeve civile. Forcat nën drejtimin e tij ishin përgjegjëse për sulmet në konviktet e Universitetit të Teheranit më 14 qershor 2009 dhe torturimin e studentëve në bodrumin e Ministrisë (niveli famëkeq i bodrumit 4). Protestuesit e tjerë u abuzuan rëndë në Qendrën e Paraburgimit në Kahrizak, e cila drejtohej nga policia nën kontrollin e Mahsouli.	10.10.2011



SHQIP

OJ L, 7.4.2025

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
54.	TAMADDON Morteza (i njohur gjithashtu si TAMADON Morteza)	Vendi i lindjes: Shahr Kord-Isfahan (Iran) Data e lindjes: 1959 Gjinia: mashkull Funksioni: Anëtar Bordi në Universitetin e Teknologjisë Khajeh Nasireddin Tusi, ish- kreu i Këshillit të Sigurisë Publike të provincës së Teheranit; ish-Guvernatori i Përgjithshëm i IRGC-së i provincës së Teheranit	Politikan i lidhur ngushtë me ish-presidentin iranjan Ahmadinejad. Anëtar bordi në Universitetin e Teknologjisë Khajeh Nasireddin Tusi. Ish- kreu i Këshillit të Sigurisë Publike në provincën e Teheranit. Ish- Guvernatori i Përgjithshëm i IRGC-së i provincës së Teheranit. Në cilësinë e tij si Guvernator dhe Kryetar i Këshillit të Sigurisë Publike provinciale të Teheranit, ai mbante përgjegjësi të përgjithshme për të gjitha aktivitetet reprezive të ndërmara nga IRGC në provincën e Teheranit, duke përfshirë goditjen e protestave politike që nga qershori 2009.	10.10.2011
57.	HAJMOHAM-MADI Aziz (i njohur gjithashtu si Aziz Hajmohammadi, Noorollah Azizmohammadi)	Vendi i lindjes: Teheran (Iran) Data e lindjes: 1948 Gjinia: mashkull Funksioni: Avokat në Teheran që nga viti 2020; ish-gjyqtar në degën 71 të Gjykatës Penale Provinciale të Teheranit	Avokat në Teheran që nga viti 2020. Ish gjyqtar në degën 71 të Gjykatës Penale Provinciale të Teheranit. Duke punuar për gjyqësorin që nga viti 1971, ai ka qenë i përfshirë në disa gjyqe të demonstruesve, duke përfshirë atë të Abdol-Reza Ghanbarit, një mësues i arrestuar në janar 2010 dhe i dënuar me vdekje për aktivitetet e tij politike. Ai ka një histori të shkeljeve të të drejtave të njeriut, duke përfshirë dhënien e dënimeve çnjerëzore, dënimet me vdekje dhe dënimet me burg për të burgosurit politikë.	10.10.2011
58.	BAGHERI Mohammad-Bagher	Data e lindjes: 1941 Gjinia: mashkull Funksioni: Zëvendëskryetar i Gjyqësorit për Çështje Ndërkombëtare dhe Sekretar i Shtabit të të Drejtave të Njeriut	Në vitin 2019, Mohammad-Bagher Bagheri u emërua Zëvendës Shef i Gjyqësorit për Çështje Ndërkombëtare dhe Sekretar i Shtabit të të Drejtave të Njeriut, duke zëvendësuar në këtë detyrë Mohammad Javad Larjani me dekrete të Ebrahim Raisit. Ai ishte gjyqtar në Gjykatën e Lartë midis dhjetorit 2015 dhe 2019. Ish-nënkryetar i administratës gjyqësore të provincës së Khorasanit Jugor, i ngarkuar për parandalimin e krimit. Përveç pranimit të tij, në qershor 2011, 140 ekzekutime për vepra penale nga marsi 2010 deri në mars 2011, rreth 100 ekzekutime të tjera raportohej se kanë ndodhur në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtën provincë të Khorasanit të Jugut pa u njoftuar as familjet dhe as avokatët e të ekzekutuarve. Prandaj, ai ishte bashkëpunëtor në një shkelje të rëndë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke kontribuar në një numër të madh të dënimeve me vdekje.	10.10.2011



OJ L, 7.4.2025

SHQIP

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
73.	FARHADI Ali	Gjinia: mashkull Funksioni: Kryetar i Organizatës Penale Qeveritare; ish Zëvendës Shef i Inspektoratit të Çështjeve Ligjore dhe Inspektimit Publik të Ministrisë së Drejtësisë së Teheranit, ish-prokuror i Karaj	Në vitin 2024, Ali Farhadi u emërua nga Ministri i Drejtësisë iraniane si kryetar i Organizatës Penale Qeveritare, e cila është një organizatë që i mungon paanshmëria dhe nuk respekton të drejtat e qytetarëve. Ish nënkryetari i Inspektoratit të Çështjeve Ligjore dhe Inspektimit Publik të Ministrisë së Drejtësisë së Teheranit. Ish-prokuror i Karaj. Përgjegjës për shkelje të rënda të drejtave të njeriut, duke përfshirë ndjekjen e gjuqeve në cilat u shqiptua dënimi me vdekje. Një numër i madh ekzekutimesh ka pasur në qarkun e Karajit gjatë kohës që ai ishte prokuror.	23.3.2012
79.	RASHIDI AGHDAM Ali Ashraf	Gjinia: mashkull Funksioni: Zëvendës Drejtor i Shëndetësisë, Korrigjimit dhe Edukimit për Burgjet e Teheranit, ish-kreu i burgut Diesel Abad në Kermanshah	Zëvendës-drejtor i Shëndetësisë, Korrigjimit dhe Edukimit për Burgjet e Teheranit që nga viti 2015. Ish-kreu i burgut Evin (2012-2015) dhe i burgut Diesel Abad në Kermanshah. Gjatë mandatit të tij, kushtet në burgje u përkeqësuan dhe raportet për mëndimin keqtrajtimin e intensifikuar të të burgosurve. Në tetor të vitit 2012, nëntë të burgosura hynë në grevë urie në Burgun e Evinit në shenjë proteste ndaj shkeljes së të drejtave të tyre dhe trajtimit të dhunshëm nga gardianët e burgut.	12.3.2013
107.	VAHIDI Ahmedi و. هادی	Vendi i lindjes: Shiraz (Iran) Data e lindjes: 27.7.1958 Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Funksioni: Anëtar i Këshillit të Përshtatshmërisë, ish ministër i Brendshëm	Ahmad Vahidi u emërua anëtar i Këshillit të Përshtatshmërisë për një mandat 5-vjeçar më 22 shtator 2022. Ai ishte Ministër i Brendshëm iranjan nga 25 gusht 2021 deri në 2024. Si i tillë, ai ishte përgjegjës për Forcat e Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF). Gjatë kohës së tij në detyrë, një numër i paprecedentë zyrtarësh ushtarakë dhe të sigurisë u emëruan në guvernatat provinciale të cilët vazhdojnë të luajnë role kyçe në koordinimin e aktiviteteve të kontrollit të turmës nga forcat speciale të policisë, milicia Basij dhe Korpusi i Gardës Revolucionare Islamike (IRGC). Shkeljet flagrante dhe të rënda të të drejtave të njeriut nga LEF, të tilla si të shtënat pa dallim me municione të drejtpërdrejta ndaj protestuesve paqësorë, përfshirë femijë, janë dokumentuar gjerësisht që nga fillimi i protestave rreth vdekjes së Mahsa Amini në mesin e shtatorit 2022. Mbi 70 protestues kanë vdekur dhe qindra janë plagosur rëndë, duke përfshirë femijë. Që nga fillimi i demonstratave, forcat policore kanë arrestuar në mënyrë arbitrare edhe shumë mbrojtës të të drejtave të njeriut dhe gazetarë. Vahidi ighthashu ka mbrojtur publikisht për një qasje të ashpër ndaj personave që marrin pjesë në demonstrata. Prandaj ai është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	14.11.2022



SHQIP

OJ L, 7.4.2025

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
125.	MOHAMEDIAN Abbas-Ali عيسى ابدين محمد	Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Funksioni: Komandant i Policisë së Teheranit të Madh; ish-kreu i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) në provincën Alborz (Kara).	Abbas-Ali Mohammadian ka qenë komandanti i policisë së Teheranit të Madh që nga janari 2023. Ai është ish-kreu i Forcave të Zbatimit të Ligjit të Iranit (LEF) në provincën Alborz (Kara), një pozicion që e mbajti nga viti 2017 deri në 2023. Alborz (Kara) është një provincë ku janë zhvilluar demonstrata të mëdha që nga shtatori 2022, të cilat janë përballur me dhunë të tepruar policore. Forcat e sigurisë shpesh kanë qëlluar drejtpërdrejt mbi protestuesit paqësorë, duke çuar në shumë vdekje, duke përfshirë edhe fëmijë. Si komandant policie i Teheranit të Madh, ai është përgjegjës për zbatimin e politikave që shkelin të drejtat e grave. Si ish-kreu i LEF në provincën Alborz (Kara) dhe komandant aktual i policisë së Teheranit të Madh, Abbas-Ali Mohammadian është përgjegjës për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	14.11.2022
140.	MIRAHMADI Sejjid Mexhid سید محمد آید محمدی	Vendi i lindjes: Iran Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Grada: Gjeneral Brigade Funksioni: Shef i Shtabit Qendror të Arbaimit; ish-zëvendësministri i Brendshëm i Iranit	General brigade Seyyed Majid Mirahmadi është kreu i Shtabit Qendror të Arbaeen - një pozicion i mbajtur tradicionalisht nga anëtarët e forcave të sigurisë. Ai ishte zëvendësministër i Brendshëm i Iranit deri në vitin 2024, përgjegjës për mbikëqyrjen e forcave të sigurisë dhe policisë së Iranit, aktorë që janë të përfshirë në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran. Forcat e sigurisë dhe policisë së Iranit po shtypin me dhunë protestat, duke qëlluar drejtpërdrejt mbi protestuesit paqësorë dhe duke arrestuar në mënyrë arbitrare njerëz me shpërfillje totale të të drejtave të tyre njerëzore. Mirahmadi në deklaratat e tij i referohet protestave si trazira që duhet të marrin fund dhe i kriminalizon dhe kërcënon pjesëmarrësit në protesta paqësore. Ai gjithashtu po zbardh personalisht shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut të kryera nga forcat nën autoritetin e tij, për shembull, duke pretenduar se protestuesi 16-vjeçar Nika Shakrami kreu vetëvrasje. Raportet tregojnë se ka shumë të ngjarë që ajo të ketë vdekur në duart e forcave të sigurisë. Prandaj ai është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	12.12.2022



OJ L, 7.4.2025

SHQIP

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
145.	KARIMI Mohsen کاریمی محمد	Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Grada: Gjeneral Brigade Funksioni: Këshilltar i Lartë i Komandantit të Forcave Tokësore të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC); ish-komandant i Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) në provincën Markazi	Që nga maji 2024, gjeneral brigade Mohsen Karimi është Këshilltar i Lartë i Komandantit të Forcave Tokësore të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC). Ai është ish-komandant i IRGC-së në provincën e Markazit, i njohur edhe si Korpusi Ruhollah, Korpusi Ruhollah është një njësi ushtarake e IRGC-së me selinë e saj të vendosur në Arak dhe është përgjegjëse për komandimin dhe kontrollin e të gjitha njësive të IRGC dhe Basij të vendosura në provincën Markazi. Ai është përgjegjës për shtypjen e dhunshme të protestave nga forcat e sigurisë në vitin 2022, të cilat çuan në vdekjen e 19-vjeçarit Mehrshad Shahidi në një qendër paraburgimi të IRGC-së në Arak. Prandaj ai është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	12.12.2022
177.	MOSTAFAVI Sejed Mojtaba مستافی سید محمد (i njohur gjithashtu si MORTAZAVI, Mojtaba; MOSTAF, Mojtaba)	Data e lindjes: 2.4.1987 Vendi i lindjes: Teheran, Iran Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull ID kombëtare: Nr 0080467741 (Iran) Funksioni: Anëtar i Ministrisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Iranit (MOIS); bashkëthemelues dhe CEO i Ravin Academy	Seyed Mojtaba Mostafavi është një anëtar i Ministrisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Iranit (MOIS) dhe bashkëthemelues dhe CEO i Akademisë Ravin të listuar në BE, një ent që trajnon individë në sigurinë kibernetike dhe hakërim, dhe rekruton nga këta të trajnuar për MOIS. MOIS është përfshirë gjerësisht në infiltrimin e grupeve të brendshme të opozitës, monitorimin e kërcënimeve të brendshme dhe mospajtimet e emigrantëve dhe arrestimin e spiuveve dhe disidentëve të dyshuar. Prandaj, Seyed Mojtaba Mostafavi është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	20.2.2023



SHQIP

OJ L, 7.4.2025

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
185.	NESARI Habibollah Jan حبيب الله جان ناري	Vendi i lindjes: Iran Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Grada: Gjeneral Brigade Funksioni: Komandant i Universitetit të Trajnimit të Oficerëve Policor Imam Hassan Mufataba, ish-zëvendës përgjegjës për trajnimin dhe edukimin për Forcat e Zbatimit të Ligjit të Republikës Islamike të Iranit (LEF)	Arsyet General brigade Habibollah Jan Nesari ka qenë komandant i Universitetit të Trajnimit të Oficerëve Policor Imam Hassan Mufataba që nga fundi i vitit 2023. Ai është ish-zëvendës i ngarkuar për trajnimin dhe edukimin për Forcat e Zbatimit të Ligjit të Republikës Islamike të Iranit (LEF) të listuara në BE, post të cilin e mbajti nga viti 2019 deri në vitin 2023. Nga viti 2016 deri më 30 dhjetor 2019, ai ka shërbyer si zëvendëskomandant i Njësive Speciale të LEF. Në cilësinë e tij si zëvendëskomandant, ai ishte përgjegjës për mbikëqyrjen e forcave në përdorimin e armëve vdekjeprurëse dhe jovekjeprurëse gjatë protestave mbarekombëtare në nëntor 2019, të cilat rezultuan në vdekjen e qindra protestuesve. Ai u shpall fajtor për krime kundër njerëzimit nga Gjykata Ndërkombëtare Popullore për Mizoritë e Iranit për rolin e tij në shtypjen e protestuesve në cilësinë e tij si zëvendëskomandant. Si pjesë e forcave të sigurisë, forcat e policisë rezultojnë se kanë hartuar dhe zbatuar një plan për kryerjen e krimeve kundër njerëzimit, si dhe vrasje, burgosje, zhdukje me forcë, tortura dhe dhunë seksuale me qëllim shuarjen e protestave dhe fsheljen e krimeve të kryera gjatë protestave të nëntorit 2019. Si zëvendës komandant i ngarkuar me trajnimin dhe edukimin për LEF dhe si komandant i Universitetit të Trajnimit të Oficerëve Policor Imam Hassan Mufataba, Nesari ka qenë personalisht përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga LEF. LEF, të cilin ai e ka trajnuar, mori pjesë në shtypjen e dhunshme të protestuesve gjatë protestave që shpërthyen në shtator 2022, duke përfshirë përdorimin vdekjeprurës të forcës kundër protestuesve iraniane. Prandaj ai është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	20.2.2023



OJ L, 7.4.2025

SHQIP

	Emri	Information identifikues	Arsyet	Data e listimit
202.	SHARIF Ramazan شريف رمضان	Vendi i lindjes: Iran Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Funksioni: Shef i Qendrës së Dokumentacionit dhe Kërkimit të Mbrojtjes së Shenjtë të Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC); ish-zëdhënës i IRGC-së	Ramezan Sharif ka qenë kreu i Qendrës së Dokumentacionit dhe Kërkimit të Mbrojtjes së Shenjtë të Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) që nga korriku 2024. Ai është një ish-zëdhënës i IRGC. IRGC ka qenë shumë e përfshirë në shtypjen aktive dhe të dhunshme të protestave në Iran në 2022 dhe 2023 dhe për këtë arsye është përgjegjëse për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Në rolin e tij, Sharif po mbulon dhe fal shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut të kryera nga IRGC. Prandaj, Ramezan Sharif është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	20.2.2023
203.	JOMEIRI Fathollah فتح الله جمیری	Vendi i lindjes: Iran Kombësia: Iraniane Gjinia: mashkull Grada: Gjeneral Brigade Funksioni: Shef i Organizatës për Mbrojtjen e Inteligjencës së Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC)/Njësisë së Sigurisë së IRGC-së	Gjeneral brigade Fathollah Jomeiri është kreu i Organizatës së Mbrojtjes së Inteligjencës të Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC), e quajtur edhe Njësia e Sigurisë së IRGC. Kjo njësi është përgjegjëse për mbrojtjen e infrastrukturës jetike dhe zonave kyçe të vendit, individëve të rëndësishëm, si VIP-at e regjimit, por mbi të gjitha mbrojtjen e regjimit. IRGC ka qenë shumë e përfshirë në shtypjen aktive dhe të dhunshme të protestave në Iran në 2022 dhe 2023 dhe për këtë arsye është përgjegjëse për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Në rolin e tij, Jomeiri po drejton, lehtëson dhe fal shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut të kryera nga IRGC. Prandaj, Fathollah Jomeiri është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	20.2.2023



SHQIP

OJ L, 7.4.2025

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
224.	NIKVARZ Mohsen محمد نیکو زر	Vendi i lindjes : Iran Gjinia: mashkull Kombësia: iranien Funksioni: Shef i Departamentit të Mbrojtjes Gjyqësore dhe Informacionit të Prokurorisë në Provincën Kerman; ish-prokuror publik i Sirjanit	Mohsen Nikvarz ka qenë kreu i Departamentit të Mbrojtjes Gjyqësore dhe Informacionit të Prokurorisë në Provincën Kerman që nga janari 2024. Si prokuror publik i Sirjanit, Mohsen Nikvarz ishte përgjegjës për disa arrestime arbitrare të avokatëve dhe për sigurimin e dënimeve me vdekje në Sirjan gjatë protestave të vitit 2019. Në vitin 2023, ai u gradua në krye të Qendrës për Mbrojtjen dhe Inteligjencën e Gjyqësorit të provincës Kerman. Në kuadër të protestave që shpërthyen në shtator 2022, Nikvarz u përfshi në çështjen Maryam Arvin, duke e ndjekur penalisht për aktivitetet e saj si avokate mbrojtëse e protestuesve. Pas arrestimit të saj, për të cilin Nikvarz mban përgjegjësi personale, Maryam Arvin u torturua brutalisht në burg. Prandaj, Mohsen Nikvarz është përgjegjës për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në Iran.	22.5.2023'



2025/690

7.4.2025

COUNCIL DECISION (CFSP) 2025/690
of 4 April 2025
amending Decision 2011/235/CFSP concerning restrictive measures directed against certain persons
and entities in view of the situation in Iran

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 12 April 2011, the Council adopted Decision 2011/235/CFSP ⁽¹⁾.
- (2) On the basis of a review of Decision 2011/235/CFSP, the Council considers that the restrictive measures set out therein should be renewed until 13 April 2026.
- (3) The Council has concluded that the entries concerning two persons designated in the Annex to Decision 2011/235/CFSP should be removed, and that the entries concerning 20 persons should be updated.
- (4) Decision 2011/235/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

Decision 2011/235/CFSP is amended as follows:

- (1) in Article 6, paragraph 2, the date '13 April 2025' is replaced by that of '13 April 2026';
- (2) the Annex is amended in accordance with the Annex to this Decision.

Article 2

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 4 April 2025.

For the Council

The President

A. SZLAPKA

⁽¹⁾ Council Decision 2011/235/CFSP of 12 April 2011 concerning restrictive measures directed against certain persons and entities in view of the situation in Iran (OJ L 100, 14.4.2011, p. 51, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2011/235/oj>).



EN

OJ L, 7.4.2025

ANNEX

The Annex to Decision 2011/235/CSP ('List of persons and entities referred to in Articles 1 and 2') is amended as follows:

(1) in the list headed 'Persons', entries 68 (concerning RAMIN Mohammad-Ali) and 169 (concerning NILFRUSHAN Abbas Mortaza) are deleted;

(2) in the list headed 'Persons', the entries for the following 20 persons are replaced by the following:

Persons			
	Name	Identifying information	Reasons
23.	PIR-ABASSI Abbas	Gender: male Function: Judge at the Shahid Mufteh Judicial Complex; former magistrate of a criminal chamber; former judge, Tehran Revolutionary Court, branch 26	Judge at the Shahid Mufteh Judicial Complex. Former magistrate of a criminal chamber. Former judge, Tehran Revolutionary Court, branch 26. He was in charge of post-election cases. He issued long prison sentences during unfair trials against human rights activists and issued several death sentences for protesters.
29.	BOZORGNIA Mostafa	Gender: male Function: Head of ward 350 of Evin Prison	Head of ward 350 of Evin Prison, known for being the place of imprisonment of the regime's political prisoners and for its particularly poor detention conditions. He unleashed on a number of occasions disproportionate violence upon prisoners.
33.	ABBASZADEH-MESHKINI Mahmud	Gender: male	Member of Parliament from February 2020 to 2024 and Speaker of the Parliament's Committee for National Security and Foreign Affairs who continues to support the Iranian regime, including by justifying the abuses committed by the regime against the "Women, Life, Freedom" movement. Advisor to Iran's High Council for Human Rights until 2019. Former secretary of the High Council for Human Rights. Former Governor of Ilam Province. Former Political Director of the Interior Ministry. As Head of the Article 10 Committee of the Law on Activities of Political Parties and Groups, he was in charge of authorising demonstrations and other public events and registering political parties. In 2010, he suspended the activities of two reformist political parties linked to Mir-Hossein Mousavi – the Islamic Iran Participation Front and the Islamic Revolution Mujahedeen Organisation. From 2009 onwards, he has consistently and continuously prohibited all non-governmental gatherings, and has therefore denied the constitutional right to protest and caused many arrests of peaceful demonstrators in contravention of the right to freedom of assembly. In 2009, he also denied the opposition a permit for a ceremony to mourn people killed in protests over the presidential elections.



OJ L, 7.4.2025

EN

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
40.	HABIBI Mohammad Reza	Gender: male Function: Chief Justice of Isfahan; former Attorney General of Isfahan; former Deputy Prosecutor of Isfahan; former Head of the Ministry of Justice office in Yazd	Chief Justice of Isfahan, former Attorney General of Isfahan, former Deputy Prosecutor of Isfahan and former Head of the Ministry of Justice office in Yazd. In his various roles in the judiciaries of Isfahan and Yazd, including in his current role as Chief Justice of Isfahan, he has directly participated in and is responsible for the violation of citizens' rights, in particular the right to freedom of speech, the right to protest, the right to life, and the violation of the prohibition on torture. Mohammad Reza Habibi also played a direct role in the suppression and gross violation of the right to protest during the nationwide protests in January 2017 and November 2019. Therefore, in his role as Chief Justice of Isfahan, he is responsible for serious human rights violations in Iran.	10.10.2011
46.	KAMALIAN Behrouz (a.k.a. Hackers Brain, Behrooz_Ice)	POB: Tehran (Iran) DOB: 1983 Gender: male Function: Head of the "Ashiyaneh" cyber group	Head of the "Ashiyaneh" cyber group linked with the Iranian regime. "Ashiyaneh" Digital Security, founded by Behrouz Kamalian, is responsible for intensive cyber-attacks on both domestic opponents and reformists and foreign institutions. Kamalian's "Ashiyaneh" organisation's work has assisted the regime's crackdown against the opposition, which has involved numerous serious human rights violations.	10.10.2011
48.	MAHSOULI Sadeq (a.k.a. MAHSOULI Sadeq)	POB: Oroumieh (Iran) DOB: 1959/1960 Gender: male Function: Secretary-General (and former Deputy Secretary-General) of the Paydari Front (Front of Islamic Stability)	Secretary-General of the Paydari Front (Front of Islamic Stability) since 2021, and Deputy Secretary-General of the Paydari Front before 2021. The Paydari Front has long been active in state capture practices, infiltrating institutions and indoctrinating the Islamic Revolutionary Guard Corps (IRGC). In the wake of the "Women, Life, Freedom" movement, launched in September 2022, the Paydari Front, under the leadership of Mahsouli, played a critical role in pushing through the draconian hijab and chastity laws. Mahsouli is a former advisor to former President Mahmoud Ahmadijhad. He is also a former member of the Expediency Council and former Deputy Chief of the Perseverance Front. He was Minister of Welfare and Social Security between 2009 and 2011 and Minister of the Interior until August 2009. As Minister of the Interior, Mahsouli had authority over all police forces, interior ministry security agents, and plain-clothes agents. The forces under his direction were responsible for attacks on the dormitories of Tehran University on 14 June 2009 and the torture of students in the basement of the Ministry (the notorious basement level 4). Other protestors were severely abused at the Kahrizak Detention Centre, which was operated by police under Mahsouli's control.	10.10.2011

ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2025/690/oj>

3/10



EN

OJ L, 7.4.2025

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
54.	TAMADDON Morteza (a.k.a. TAMADON Morteza)	POB: Shahr Kord-Isfahan (Iran) DOB: 1959 Gender: male Function: Board member at Khajeh Nasireddin Tusi University of Technology; former Head of Tehran provincial Public Security Council; former IRGC Governor-General of Tehran Province	Politician closely associated with former Iranian President Ahmadinejad. Board member at Khajeh Nasireddin Tusi University of Technology. Former Head of Tehran provincial Public Security Council. Former IRGC Governor-General of Tehran Province. In his capacity as Governor and Head of Tehran provincial Public Security Council, he bore overall responsibility for all repressive activities undertaken by the IRGC in Tehran Province, including cracking down on political protests since June 2009.	10.10.2011
b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

ç) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në *manualin tokësor* (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virus i gjallë i inaktivuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen gjithashtu në certifikatë).



2.3 Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se këto produkte:

a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga Autoriteti Veterinar i vendit eksportues.

3. Urdhri nr. 443, datë 7.5.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Greqisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

NJOFTIM
Nr. 6886, datë 14.5.2025

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

“Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve lidhur me hapjen e përfaqësisë së Bankës Evropiane të Investimeve në Shqipëri”, nënshkruar në Tiranë, më 24.1.2025, hyn në fuqi më 22 prill 2025.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

URDHËR
Nr. 121, datë 19.5.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 12, pika 1 dhe nenit 13, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 7, pika 2, germa “c” e rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, në mungesë të Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, gjyqtarës Mimoza Tasi, për datat 22 dhe 23 maj 2025. Kjo kompetencë nuk mund të nëndelegohet.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet gjyqtarja Mimoza Tasi dhe të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo

VENDIM
Nr. 19, datë 10.4.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;

me sekretare Belma Lleshi, më datë 10.4.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të



dokumenteve çështjen nr. 24 (E) 2024 të Regjistrat Themeltar që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “EKZON KALAJA COMFORT” SH.P.K., përfaqësuar nga avokat Arben Doda, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

DREJTORIA RAJONALE TATIMORE LEZHË, përfaqësuar nga juristi Jetnor Sherri.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 819, datë 21.3.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 16, pika 2, 17, 41, 42, 49, 57, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 49, 50, 70 dhe 71, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkeses, shoqërisë “Ekzon Kalaja Comfort” sh.p.k. (*kërkesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë (DRT), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Më datë 22.4.2010, kërkesja është regjistruar si tatimpaguese në DRT-në, Lezhë, me objekt aktiviteti në fushën e turizmit, ndërtimit dhe tregtimit me shumicë e pakicë etj. Në bazë të urdhrit nr. 1198, datë 19.7.2016, të drejtorit të DRT-së, Lezhë, inspektorët tatimorë të Drejtorisë së Verifikimit dhe të Koordinimit në Terren të DRT-së, Lezhë, më datë 20.7.2016 kanë ushtruar kontroll në adresën ku ushtronte aktivitetin kërkesja.

2. Pas kontrollit të ushtruar inspektorët tatimorë kanë mbajtur aktkonstatimin e datës 20.7.2016, sipas të cilit rezultonte se kërkesja nuk lëshonte kuponë tatimorë për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të shërbimeve dhe të mallrave, si dhe nuk kishte përditësuar ndryshimin e të dhënave. Inspektorët tatimorë kanë mbajtur procesverbalin e gjobës së datës 20.7.2016 për gjobitjen e kërkeses në shumën 50.000 lekë për konstatimin e moslëshimit të kuponëve tatimorë. Bazuar në aktin e konstatimit dhe në bazë të verifikimeve të kryera në sistemin CATS, Sektori i Verifikimit në Terren në Drejtorinë e Kontrollit të DRT-së, Lezhë ka mbajtur aktvlerësimin e datës 26.7.2016, nga ku ka rezultuar se kërkesja nuk e ka deklaruar aktivitetin “Bar-restorant-hotel”, ndaj është gjobitur në shumën 10.000 lekë.

3. Në vijim, DRT-ja, Lezhë, pasi është njohur me aktet e mësipërme, ka vijuar procedurat përkatëse dhe ka nxjerrë aktin administrativ “Njoftim vlerësimi për detyrimet” nr. 15042/4 prot., datë 4.8.2016, të cilin ia ka komunikuar kërkeses në adresën e deklaruar. Kjo e fundit është njohur me aktin e mësipërm, por nuk ka ushtruar ankim administrativ në Drejtorinë e Apelimit Tatimor.

4. Në fund të vitit 2015 Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) kishte filluar shqyrtimin e kërkesës së një shoqate, me objekt shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të neneve 5, 7, 11, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20, të ligjit nr. 99/2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 99/2015*), i cili ka hyrë në fuqi më datë 12.11.2015. Gjykata, me vendimin përfundimtar nr. 33, datë 8.6.2016 (*vendimi nr. 33/2016*), ka vendosur shfuqizimin e neneve 5, 14, 15, 16 (pika 4 e shtuar në nenin 121), 17, pikat 1 dhe 2, 18 (pika 2 e nenit 124) dhe 20 të ligjit nr. 99/2015, si të papajtueshme me Kushtetutën. Ky vendim ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 108, datë 16.6.2016.

5. Në vijim, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 112/2016, datë 3.11.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 112/2016*), ku, ndër të tjera, ka pasqyruar edhe ndryshimet përkatëse që lidheshin me dispozitat e shfuqizuara nëpërmjet vendimit nr. 33/2015 të Gjykatës. Ligji nr. 112/2016 është



botuar në Fletoren Zyrtare nr. 219, datë 15.11.2016 dhe ka hyrë në fuqi më datë 30.11.2016.

6. Në vitin 2023, kërkesja ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesëpadi, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të njoftimit të vlerësimit për detyrimet të DRT-së, Lezhë, për shkak se ligji mbi bazën e të cilit ishte disponuar dhënia e gjobës ndaj saj ishte shfuqizuar.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 819, datë 21.3.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuësës. Në dispozitivin e vendimit përcaktohet se ai është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim. Pavarësisht kësaj, kërkesja, më datë 28.5.2024 ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin e datës 31.5.2024, ka vendosur mospranimin e ankimit të saj.

8. Më datë 22.8.2024, kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më datë 23.9.2024. Më datë 11.11.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkesja**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

9.1.1 *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së saj, në kushtet kur DRT-ja, Lezhë ka vepruar jashtë kompetencës së saj e në kundërshtim flagrant me ligjin dhe vendimin nr. 33/2016 të Gjykatës, duke e gjobitur kërkuësen në bazë të një dispozite të shfuqizuar të ligjit nr. 9920/2008. Në momentin e vënies së gjobës nuk ka pasur dispozitë ligjore në fuqi për gjobitjen e kërkuësës nga DRT-ja, Lezhë, pasi neni 122 i tij ishte shfuqizuar nëpërmjet vendimit nr. 33/2016 të Gjykatës. Ndryshimet e nenit 122 të ligjit nr. 9980/2008 janë miratuar me ligjin nr. 112/2016, i cili ka hyrë në fuqi më datë 30.11.2016. Vendimi nr.

33/2016 i Gjykatës nënkuptonte moszbatimin e mëtejshëm të atij ligji jo vetëm nga palët në gjykimin kushtetues, por nga të gjitha autoritetet shtetërore, për më tepër nga gjykata.

9.1.2 *Parimit të ligjshmërisë*, të garantuar nga neni 4, pika 1, i Kushtetutës, pasi gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuësës edhe pse konstatimi i bërë nga DRT-ja, Lezhë ishte i qëllimshëm, i padrejtë dhe në kundërshtim flagrant me ligjin. Grupi i inspektimit të DRT-së, Lezhë është ngritur në kundërshtim me ligjin, pasi inspektimi është kryer nga një organ që në përbërjen e tij ka pasur persona të cilët nuk e gëzonin cilësinë e inspektorit tatimor. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 108 të Kodit të Procedurave Administrative (KPA), aktet e nxjerra nga ky organ janë absolutisht të pavlefshme.

9.1.3 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit dhe të drejtën e ankimit efektiv*, pasi gjykata e shkallës së parë nuk e ka respektuar haptazi vendimin nr. 33/2016 të Gjykatës. Ajo gjykatë duhet të konstatonte se organi tatimor e ka zhvilluar veprimtarinë e tij në kundërshtim të hapur me vendimin nr. 33/2016 të Gjykatës, fakt i parashtruar nga kërkesja në kërkesëpadi dhe në seancë gjyqësore. Edhe pse ky pretendim është pasqyruar në vendim, gjykata e shkallës së parë e ka anashkaluar, duke mos u shprehur për bazueshmërinë e tij.

9.2 *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, si pasojë e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë.

10. **Subjekti i interesuar, DRT-ja, Lezhë**, në mënyrë të përmblodhur, ka prapësuar se:

10.1 Pretendimi për cenimin e procesit të rregullt ligjor nuk qëndron, pasi akti administrativ është marrë pas një hetimi të rregullt dhe një procedimi që respekton të drejtat procedurale të kërkuësës, duke i dhënë mundësinë e mbrojtjes dhe të apelimit në rrugë administrative, me qëllim mbrojtjen e interesave të saj. Nëpërmjet aktit administrativ DRT-ja, Lezhë ka vepruar në përputhje me detyrimet ligjore dhe kushtetuese për të siguruar mbledhjen e taksave dhe ndëshkimin e shkeljeve tatimore, duke respektuar ligjin dhe parimet e drejtësisë.

10.2 Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës është i pabazuar, pasi kërkesja, si çdo subjekt tjetër ekonomik, ka detyrimin të respektojë normat tatimore të vendosura nga shteti. Vendosja



e gjobës për shkelje të normave fiskale është në përputhje me parimet e Kushtetutës. Sipas nenit 41 të Kushtetutës, çdo individ gëzon të drejtën e pronës, por kjo e drejtë është subjekt i kufizimeve që vendosen për mbrojtjen e interesave të përgjithshëm të shoqërisë, përfshirë mbledhjen e taksave dhe përfitimin nga shërbimet publike.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuës

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kërkuësja, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i së drejtës private dhe bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe legjitimohet *ratione personae*, në përputhje me nenet 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vendimin gjyqësor të së cilës ajo kundërshton.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime, për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 17, datë 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull

synon t’u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose të korrigojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike efektive përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime tek organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Subjekti i interesuar, DRT-ja, Lezhë, ka prapësuar se kërkuësja nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave të saj, pasi nuk ka ndjekur instancat e zakonshme të ankimit përpara se t’i drejtohej Gjykatës. Lidhur me këtë, Gjykata konstaton se objekti i ankimit kushtetues individual është shfuqizimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në dispozitivin e të cilit është shënuar se ai është i formës së prerë dhe i paankimueshëm. Kjo do të thotë se paraqitja e kërkesës së saj në Gjykatë është zgjedhje e vetë kërkuësës, mbështetur në objektin e padisë së saj për pavlefshmërinë absolute të akteve. Për rrjedhojë, mbështetur në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuësja e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese.

15. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Gjykata ka theksuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).



16. Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar nga kërkesja mban datën 21.3.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur më datë 22.8.2024. Ndërkohë kërkesja është informuar për vendimin nga gjykata e shkallës së parë me shkresën nr. 3595/1, datë 22.5.2024. Duke iu referuar kësaj date si momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave themelore, rezulton se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, rrjedhimisht kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

17. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar se nga vendimi gjyqësor i kundërshtuar asaj i janë cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në aspektet e parimit të sigurisë juridike, ligjshmërisë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit e të ankimit efektiv, si dhe e drejta e pronës, të garantuara nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës, të cilat janë me natyrë kushtetuese.

18. Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të ligjshmërisë, të garantuar nga neni 4, pika 1, i Kushtetutës, kërkesja ka argumentuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së saj edhe pse konstatimi i bërë nga DRT-ja, Lezhë është i qëllimshëm, i padrejtë dhe në kundërshtim flagrant me ligjin, pasi grupi i inspektimit është ngritur në kundërshtim me ligjin, ndaj, bazuar në nenin 108 të KPA-së, aktet e nxjerra nga ky organ janë absolutisht të pavlefshme. Gjykata konstaton se këto argumente, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin që gjykata e shkallës së parë i ka bërë ligjit të zbatueshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ajo ka zhvilluar. Duke qenë se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 42, datë 7.7.2014 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata çmon se pretendimi i kërkeses për cenimin e parimit të ligjshmërinë nuk mund të merret në shqyrtim, pasi ai nuk përmban argumente në nivel kushtetues.

19. Gjithashtu, kërkesja ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, si pasojë e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë.

20. Lidhur me të drejtën e pronës, në kontekst të fakteve të çështjes, Gjykata rithekson se kjo e drejtë, si e drejtë universale e njeriut, përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore. Për sa u takon detyrimeve financiare, duke

përfshirë edhe gjobën, ato janë pjesë e konceptit kushtetues të pronës private, pasi pagesa e një sasive të caktuar të hollash, e barasvlershme në këtë rast me masën e gjobave, është një shumë që merret nga pasuria e individit (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Nisur nga sa më lart, duke qenë se në rastin konkret ky pretendim, në thelb, lidhet me vlerësimin që gjykata e shkallës së parë i ka bërë çështjes në fjalë, Gjykata çmon ta trajtojë atë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

22. Për sa i takon kësaj të fundit (së drejtës për proces të rregullt ligjor), kërkesja ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit e të drejtën e ankimit efektiv, për shkak se vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë, sipas saj, është bazuar në një dispozitë ligjore të shfuqizuar. Mbështetur në thelbin e këtij argumenti, Gjykata çmon të analizojë në themel nëse gjykata e shkallës së parë ka përmbushur standardet e procesit të rregullt në këndvështrim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkesja ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë nuk e ka respektuar haptazi vendimin nr. 33/2016 të Gjykatës. Sipas kërkeses, ajo gjykatë duhet të konstatonte se organi tatimor e ka zhvilluar veprimtarinë e tij në kundërshtim të hapur me vendimin nr. 33/2016 të Gjykatës, fakt i parashtruar nga kërkesja në kërkesëpadi dhe në seancë gjyqësore. Sipas kërkeses, edhe pse ky pretendim është pasqyruar në vendim, gjykata e shkallës së parë e ka anashkaluar, duke mos u shprehur për bazueshmërinë e tij. Lidhur me këtë pretendim, subjekti i interesuar nuk ka prapësuar argumente.

24. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim



pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi akses në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehën qartësisht për forcën detyruese që vendimet e Gjykatës kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit (*shih vendimet nr. 49, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 1.3.2017; nr. 44, datë 29.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata do të verifikojë nëse kërkuessa ka marrë përgjigje përfundimtare për pretendimin se gjoba e dhënë ndaj saj është bazuar në një dispozitë ligjore të shfuqizuar, duke shqyrtuar nëse vendimi i

kundërshtuar është në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit.

28. Konkretisht, Gjykata vëren se nga njoftimi i vlerësimit, i cili caktonte ndaj kërkuesses dy gjoba për moslëshimin e kuponit tatimor dhe për mospërditësimin e të dhënave, është nxjerrë nga DRT-ja, Lezhë më datë 4.8.2016. Në përmbajtjen e atij akti nuk konstatohet ndonjë bazë ligjore, por rezulton se ai është mbështetur, ndër të tjera, edhe te procesverbali i gjobës i datës 20.7.2016, i cili bazohej tek akti i konstatimit nr. 0757743 i së njëjtës datë. Procesverbali i gjobës rezulton se është nxjerrë në zbatim të nenit 122, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 9920/2008, i cili është ndryshuar me nenin 17, pika 1, të ligjit nr. 99/2015. Ky i fundit është shfuqizuar nga Gjykata me vendimin nr. 33/2016, ndërkohë që veprimet e organit tatimor ndaj kërkuesses janë kryer në momentin kur kjo dispozitë ka qenë e shfuqizuar nga Gjykata. Dispozita e mësipërme është ndryshuar nëpërmjet nenit 51 të ligjit nr. 112/2016, i cili ka hyrë në fuqi më datë 30.11.2016. Për këtë çështje, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se akti administrativ është plotësisht i vlefshëm dhe është nxjerrë nga organi kompetent, konform parashikimeve ligjore. Sipas asaj gjykate, nuk janë konstatuar shkelje flagrante të procedurës së nxjerrjes së aktit ose të ndonjë dispozite urdhëruese që lidhet me formën e tij dhe që do të përbënte shkak për pavlefshmërinë absolute të tij (*shih faqen 9 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*), duke mos u shprehur për bazueshmërinë e pretendimit të kërkuesses në drejtim të respektimit të vendimit të Gjykatës për shfuqizimin e nenit 17, pika 1, të ligjit nr. 99/2015.

29. Nisur nga sa më lart, Gjykata konstaton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk ka arsyetuar në vendimin e saj për forcën detyruese të vendimit të Gjykatës lidhur me shfuqizimin e disa dispozitave të ligjit nr. 9920/2008 në raport me veprimet konkrete që ka kryer administrata tatimore gjatë asaj periudhe, edhe pse një pretendim i tillë ishte ngritur qartazi në kërkesëpadinë e kërkuesses, si dhe vetë ajo gjykatë e ka pasqyruar këtë pretendim në vendimin e saj. Nën këtë optikë, Gjykata çmon se gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar dhe nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesses, duke cenuar, për rrjedhojë, të drejtën e aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, ndaj pretendimet e saj janë të bazuara.



30. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuës duhet të pranohet sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 819, datë 21.3.2024, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
 3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 10.4.2025.

Shpallur, më 9.5.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim

VENDIM

Nr. 25, datë 7.5.2025

PËR VENDOSJEN E KUFIJVE TË SIPËRM PËR TREGUESIT “RAPORTI I KREDISË NDAJ VLERËS” DHE “RAPORTI I SHËRBIMIT TË BORXHIT NDAJ TË ARDHURAVE” PËR KREDITË QË JAPIN BANKAT PËR PASURI TË PALUAJTSHME REZIDENCIALE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të rregullores nr. 44, datë 4.10.2023, “Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve mbi kredidhënien dhe investimet për prona të paluajtshme”, neni 4, neni 13, neni 14, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, dhe pika

2, neni 15, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, dhe neni 16; me propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar të Bankës së Shqipërisë, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Për kredinë e re për pasuri të paluajtshme rezidenciale që japin bankat:

a) të miratojë vendosjen e kufijve të sipërm për treguesin “raporti i kredisë ndaj vlerës, në disbursim” (HnV_D), si më poshtë:

i. në lek, HnV_D të mos kapërcejë vlerën 85 për qind;

ii. në lek, për blerjen e një shtëpie të dytë (dhe vijuese) ose për t’u dhënë me qira, HnV_D të mos kapërcejë vlerën 80 për qind;

iii. në valutë, HnV_D të mos kapërcejë vlerën 75 për qind;

iv. në valutë, për blerjen e një shtëpie të dytë (dhe vijuese) ose për t’u dhënë me qira, HnV_D të mos kapërcejë vlerën 70 për qind;

b) të miratojë vendosjen e kufijve të sipërm për treguesin “raporti i shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave, në disbursim” (ShBnA_D), si më poshtë:

i. në lek, ShBnA_D të mos kapërcejë vlerën 40 për qind;

ii. në lek, për blerjen e një shtëpie të dytë (dhe vijuese) ose për t’u dhënë me qira, ShBnA_D të mos kapërcejë vlerën 35 për qind;

iii. në valutë, ShBnA_D të mos kapërcejë vlerën 35 për qind;

iv. në valutë, për blerjen e një shtëpie të dytë (dhe vijuese) ose për t’u dhënë me qira, ShBnA_D të mos kapërcejë vlerën 30 për qind;

v. për përcaktimin e vlerës së borxhit të kredimarrësit, krahas vlerës së kredisë konkrete (dhe të kredive të tjera që ai mund të ketë në sistemin financiar), banka do të përfshijë edhe çdo borxh tjetër të tij për të cilin banka ka siguruar informacion të besueshëm nga komunikimi me kredimarrësin apo konsultimi paraprak i bazave relevante të të dhënave;

c) të lejojë bankat që të zbatojnë kuota përjashtimi nga kufizimet e mësipërme në secilin prej treguesve HnV_D dhe ShBnA, me kushtin që, në total, vlera e kredive të përjashtuara të mos kapërcejë 15 për qind të vëllimit të kredive të reja që janë miratuar dhe disbursuar (edhe pjesërisht) gjatë tremujorit. Në këtë kuotë përjashtimi do të përfshihen lehtësitë e rifinancimit që jepen gjatë tremujorit për kreditë ekzistuese dhe që mund të



kapërcejnë kufirin e treguesit. Bankat duhet t'i identifikojnë kreditë dhe lehtësitë e rifinancimit që përfshihen në kuotën e përjashtimit, në mënyrë individuale dhe t'i evidentojnë ato në mënyrë të dallueshme në raportimin tremujor që kryejnë pranë Bankës së Shqipërisë;

d) të përjashtojë nga përfshirja në llogaritjen e kufizimeve sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” më sipër:

i. kreditë që disbursohen në kuadër të skemave që mbështesin politikat publike të strehimit;

ii. kreditë që disbursohen për rinovimet e banesave që lidhen me përmirësimin e efikasitetit të energjisë apo kalimin drejt burimeve të energjisë së rinovueshme, deri në vlerën 3 milionë lekë (ose kundërvlera përkatëse në valutë nëse disbursohen në valutë);

iii. disbursimin në kuadër të granteve të parikthyeshme publike që lidhen me përmirësimin e efikasitetit të energjisë apo kalimin drejt burimeve të energjisë së rinovueshme, te banesat;

e) të rekomandojë për bankat zbatimin e një kufiri maksimal në afatin e maturimit në disbursim të kredisë, pavarësisht monedhës, sa minimumi midis:

i. 30 vjet;

ii. numri i viteve deri në arritjen e moshës së pensionit të kredimarrësit (ose të kredimarrësit që e arrin këtë moshë më shpejt në rastin e kredisë me bashkëkredimarrës).

2. Ky vendim fillon të zbatohet nga bankat për kreditë e reja për pasuri të paluajtshme rezidenciale që disbursohen nga data 1 korrik 2025.

3. Ky vendim rishqyrtohet jo më vonë se 2 vjet nga data e hyrjes së tij në fuqi.

4. Ngarkohen Departamenti i Stabilitetit Financiar, Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

KËRKESË

Nr. 421/9, datë 14.5.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Qendra Multifunkionale në Luginën e Vjosës, Stacioni i Informimit Vlorë”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 1,079,595 (një milion e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogarit, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “pyll”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,079,595 (një milion e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE E TË CILËVE
SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “QËNDRA
MULTIFUNKSIONALE NË LUGINËN E VJOSËS, STACIONI I INFORMIMIT VLORE”

Nr.	PRONARI			TË DHËNA (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqja e shpronësimit (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	VLERA TOTALE (lekë)	Konfirmuar nga ASHK-ja
1	Gent	Namik	Prezereni	1007	262/4	pyll	112000	6543	165	1,079,595	1,079,595	
SHUMA PARAPRAKE											1,079,595	

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 240 lekë

